



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Bazuar ne Nenin 108/A te LPP 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, rregullores mbi Paraqitjen e Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit, date 02.07.2020

merr ketë :

V E N D I M

KEREKSA PER RISHQYRTIM ESHTË HUDHUR E BAZUAR E, O.E INTERLAB - nga PRISHTINA Ne Kerkesen Per Rishqyrtim ne Vendimin e Ak Per Shperblim me Kontrate ne Aktivitetin e prokurimi "FURNIZIM ME FILMA DIXHITAL PER RADIOLOGJI" me numer prokurimi 634-20-614-121. Te bere permes platformes e-prokurimi me date 01.07.2020

1.

AK – KOMUNA KLINE ,bazuar ne Njoftimin e OSHP nr. 296/20 e dates 19.06.2020, Ku i Ka Konstatuar se A.K, Ka shpërblyer me Kontrate me date 06.05.2020 O.E .te përgjegjeshem .

Gjate Rivleresimit eshte Konstauar se Nuk jeni te **AUTORIZUAR** te beni furnzim me Filmat e kërkuar meq Nuk keni Marevesje per Furnzim me Keta Filma Me prodhuesin .

Keshilla Juridike

Kunder këtij vendimi O.E i paknaqyr me kete ka te drejt te parashtroj Ankes pran OSHP brenda afatit te përcaktuar me LPP Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 109.

Zyra e Prokurimit Z.Abaz Foniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

296/20
19.06.20



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	19 qershor 2020
REFERENCE:	296/20
PËR/ZA/TO:	AK- Komuna Klinë
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina Kryetar i panelit shqyrtues- OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Operatori ekonomik "KosovaMed Healthcare sh.p.k"-Prishtinë, si palë e pakënaqur me datën: 13 maj 2020, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 296/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me filma digjital për radiologji" me numër të prokurimit: "634-20-614-1-2-1", duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 7, 28, 59, 60, 68, 69 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 25 maj 2020 kanë autorizuar ekspertin shqyrtues dhe teknik të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti shqyrtues dhe teknik i prokurimit me datën 08 qershor 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti kontraktues- Komuna Klinë me datën 08 qershor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues dhe të njëjtit me datën 08 qershor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues me datën 08 qershor 2020 ka pranuar nga OSHP raportin e ekspertizës dhe të njëjtit përmes parashtresës me shkrim me datën 17 qershor 2020 kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së që **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues- Komuna Klinë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me filma digjital për radiologji" me numër të prokurimit: "634-20-614-1-2-1", duhet të anulohet njoftimin mbi vendimin e AK-së, për dhënie dhe lënda të kthehet në rivlersim, konform mendimit të dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik "ND" SH.P.K-Prishtinë konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.